



AKADEMIA E SIGURISE
SENATI AKADEMIK

Nr/31. Prot.

Tiranë më 08.05.2024

VENDIM

Nr. 96, date 08.05.2024

“Për miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit dhe shkollimit për programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”, për vitin akademik 2024-2025”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” neni 98, pika 2, gërma c; neni 109, pika 1, gërma b, Statutin e Akademisë së Sigurisë neni 46, gërma o, si dhe në propozimin e administratorit të AS-së, Senati Akademik i Akademisë së Sigurisë në mbledhjen e datës 08.05.2024,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit dhe shkollimit, për programin e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, në Akademinë e Sigurisë, për vitin akademik 2024-2025, të jenë si më poshtë:


- Tarifa e regjistrimit për programin “Master i shkencave” në shumën 2500 lekë.
- Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në programin e ciklit të dytë “Master i shkencave” për vitin akademik 2024-2025 në shumën 90000 lekë.

2. Studentët në programin e ciklit të dytë, me 120 kredite, paguajnë tarifë shkollimi për dy vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor).

5. Vendimi ti përcillet Bordit të Administrimit të Akademisë së Sigurisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Senatit
Prof. Dr. Ilirjan MAMU



Tiranë 08.05.2024